



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.
____.____.2021

Tiranë, më

VENDIM
Nr. 255, datë 17.06.2021

PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT {...}, ME QËLLIM
GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relator z. Erjon Muharremaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

RAPORT

VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL ME QËLLIM
PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT (GRADIMIN) E
GJYQTARIT {...}

Ekstrakt

POLI I DREJTËSISË
RRUGA “ANA KOMNENA”
TIRANË

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekte, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nëntregues.

1.A. NJOHURITË LIGJORE

1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon shumë qartë normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Tre dokumentet e paraqitura prej tij dhe 5 dosjet gjyqësore konfirmojnë njohuritë e gjyqtarit mbi të drejtën e pronësisë (shih dosjen 3) dhe tagrën e posedimit (shih dosjen 2) mbi detyrimet kontraktore (shih dokumentin 1), mbi titujt ekzekutivë dhe veprimet përmbare (shih dokumentin 3 dhe dosjen 4) si dhe mbi gjykimin e kërkesave gjatë hetimeve paraprake (shih dosje 5). Evidenton qartësisht natyrën e mosmarrëveshjes dhe gjykatën kompetente”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:

Vendimet gjyqësore burim vlerësimi në rastin konkret ndahen në dy grupe për shkak të lëndës (civile dhe penale), kategorizim i cili ndikon edhe në mënyrën e përcaktimit dhe analizimit të fakteve të çështjes, në përcaktimin e natyrës së saj dhe identifikimin e ligjit të zbatueshëm.

Në çështjet civile, gjyqtari përcakton dhe përshkruan në mënyrë të përmbledhur faktet e çështjes në pjesën e dytë të arsyetimit të vendimit, pas parashtrimit të rrethanave procedurale dhe vlerësimit lidhur me juridiksionin dhe kompetencën. Paraqitja e fakteve të çështjes, edhe pse e pa veçuar në aspektin vizual, është e qartë dhe bëhet duke integruar edhe provat mbi të cilat kanë rezultuar faktet konkrete dhe pretendimet e palëve lidhur me faktin objekt shqyrtimi dhe kërkimet e tyre në raport me objektin e mosmarrëveshjes. Përveç përshkrimit të fakteve të çështjes në pjesën e dytë të arsyetimit të çdo vendimi, së bashku me referimin tek provat mbi të cilat ato mbështeten, rrethanat e faktit rimerren në shqyrtim në pjesën e arsyetimit ligjor, me qëllim për të mbështetur argumentet e gjyqtarit, në shërbim të konkluzioneve sa i përket objektit të padisë/çështjes apo pretendimeve të palëve ndërgjyqëse.

Në vendimin penal, referuar natyrës së gjykimit (*kërkesë penale*), rrethanat e faktit, së bashku me rrethanat procedurale të arrestimit apo caktimit të masës, përcaktohen në pjesën hyrëse të arsyetimit të vendimit, duke referuar provat e administruara në proces dhe faktet konkrete të çështjes apo elementët proceduralë për të cilët referojnë provat e administruara, duke ndjekur rendin kronologjik të prezantimit të tyre.¹

- Identifikimi i natyrës së çështjes:

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha vendimet e analizuara, natyra juridike e çështjes është e qartë dhe rezulton nga objekti i gjykimit dhe analiza e faktit. Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarit, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me juridiksionin, kompetencën lëndore dhe tokësore.

- Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm:

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, por lidhet gjithashtu edhe me identifikimin e ligjit të zbatueshëm procedural dhe material në zgjidhjen e çështjes. Në këtë drejtim, rezulton se në të gjitha vendimet, gjyqtari identifikon ligjin e zbatueshëm, citon dispozita të ligjit material ose procedural, si dhe analizon përmbajtjen e tyre, kur është vlerësuar e nevojshme, në mënyrë të integruar me faktin, ose në mënyrë të pavarur, para aplikimit mbi faktet e çështjes.

¹ Vendimi nr. 887, datë 24.03.2015;

Sa i përket ligjit procedural, gjyqtari ka referuar dhe cituar si pjesë të arsytimit të vendimit, nenet 35/2, 36/1, 41, 42, 43, 50, 52, 57 dhe 348 të K.Pr.Civile lidhur me përcaktimin e juridiksionit gjyqësor civil, si dhe kompetencën lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtimin e çështjes civile ose tregtare; nenin 451/a i K.Pr.Civile lidhur me konceptin juridik “*gjë e gjykuar*”.²

Sa i përket dispozitave të ligjit material të zbatueshëm, gjyqtari ka identifikuar dhe referuar dispozitat e ligjit material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar jo vetëm dispozitave materiale të Kodit Civil, por edhe ligjeve organike përkatëse. Konkretisht:

- Në vendimin nr. 4490, datë 08.04.2014, gjyqtari identifikon dispozitat ligjore materiale (nenet 419, 476, 479, 486, 659, 660, 690 dhe 698 të K.Civil), mbi pasojën e mospërbushjes së detyrimeve kontraktore ndërmjet palëve ndërgjyqëse. Gjithashtu, gjyqtari përcakton se zgjidhja e mosmarrëveshjes të referon tek ligjet e posaçme ku gjen rregullim kjo marrëdhënie juridike dhe për këtë qëllim citon dispozitat ligjore të ligjit të posaçëm nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

- Në vendimin nr.4103, datë 16.05.2016, gjyqtari identifikon dispozitat ligjore materiale dhe procedurale njëkohësisht (nenin 610 të K.Pr.Civile) në lidhje me normën ligjore të zbatueshme për kundërshtimin e veprimeve përmbaramore, dhe po kështu ligjin e posaçëm nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (nenet 68 dhe 73), në funksion të zgjidhjes së çështjes.

- Në vendimin nr. 10364, datë 29.10.2014, me objekt “Dëmshpërblim që rrjedh nga marrëdhëniet e punës”, gjyqtari citon dispozitat ligjore materiale: nenin 143 të K.Punës, në lidhje me afatin e njoftimit për përfundimin e marrëdhënies së punës; nenin 144 të K.Punës, në lidhje me barrën e provës që ka punëdhënësi për të provuar respektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës; nenin 153 të K.Punës, në lidhje me shkaqet e justifikuar të zgjidhjes së marrëdhënies së punës, nëse zgjidhja është bërë në mënyrë të menjëhershme; nenin 155 të K.Punës, në lidhje me zgjidhjen e menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës nga punëdhënësi, si norma relevante për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi, në lidhje me të gjitha kërkimet e palës paditëse.

- Në vendimin nr.8250, datë 21.07.2014, gjyqtari citon dispozitat e ligjit të posaçëm nr.9947, datë 07.07.2018, “Për pronësinë Industriale”, nenin 159, në lidhje me detyrimin e përdorimit të markës; nenin 173, në lidhje me shfuqizimin e markës dhe nenin 174, në lidhje me zhvleftësimin e markës.

- Në vendimin nr. 107, datë 18.01.2016, gjyqtari citon dispozitat ligjore materiale, konkretisht: nenin 83 të K.Civil, në lidhje me formën e veprimit juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to; nenin 92/a të K.Civil, në lidhje me pavlefshmërinë e veprimeve juridike; nenin 164 të K.Civil, lidhur me mënyrën e fitimit të pronësisë; nenin 298 të K.Civil, lidhur me mbrojtjen e pronësisë. Gjithashtu, gjyqtari përcakton se zgjidhja e mosmarrëveshjes të referon tek ligjet e posaçme ku gjen rregullim kjo marrëdhënie juridike dhe për këtë qëllim citon dispozitat ligjore të ligjit të posaçëm nr. 7829, datë 01.06.1994, “Për noterinë”, në lidhje me vërtetimin e nënshkrimeve në aktet private, në funksion të zgjidhjes së çështjes.

² Vendimi nr. 9381, datë 01.12.2015;

Sa i përket aspektit të evidentimit të konfliktit të normave, në vendimet e analizuara nuk rezultojnë të jetë evidentuar ndonjë rast i konfliktit të normave me karakter procedural ose material, kushtëzuar kjo edhe nga natyra e çështjeve.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë se gjyqtari ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të plotë të fakteve të çështjes, identifikimin e natyrës së çështjes, si dhe identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin e “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin normave” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Gjyqtari {...} ka aftësi të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon shumë qartë normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Tre dokumentet e paraqitura prej tij dhe 5 dosjet gjyqësore konfirmojnë njohuritë e gjyqtarit mbi të drejtën e pronësisë (shih dosjen 3) dhe tagrën e posedimit (shih dosjen 2) mbi detyrimet kontraktore (shih dokumentin 1), mbi titujt ekzekutivë dhe veprimet përmbartimore (shih dokumentin 3 dhe dosjen 4) si dhe mbi gjykimin e kërkesave gjatë hetimeve paraprake (shih dosje 5). Në shqyrtimin e veprimeve përmbartimore gjyqtari interpreton ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” përsa i përket detyrimeve të ndara që kanë shoqëria dhe ortakët ndaj të tretëve, për shkak të qenies së tyre entitete të ndryshme (shih dokumentin 3). Vihet re se gjyqtari {...} njeh dhe përdor shprehimisht parimet e përgjithshme të teorisë të së drejtës si i) parimi i barrës së provës tek i padituri, ii) disponimi i të drejtës së padisë nga paditësi (shih dosjen 1 dhe dokumentin 1). Në funksion të zbatimit të ligjit gjyqtari përdor referenca në jurisprudencë unifikuese të Gjykatës së Lartë:

vendimi nr. 901/2000 mbi të drejtën e disponimit të padisë nga paditësi (shih dosjen 1), vendimi nr. 7/2011 mbi interpretimin e nocioneve “rreziku i largimit”, “rreziku i eliminimit të provave” për të arritur në konkluzionin mbi ligjshmërinë e arrestimit në flagrancë të këtij personi, mbi ekzistencën e “dyshimit të arsyeshëm” për të arritur në konkluzionin e ekzistencës së kushteve për caktimin e masës së sigurimit personal (shih dosjen 5)”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*kryesisht asaj materiale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari lidhur me zbatimin e saj.

Normat ligjore citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes dhe në asnjë rast citimi i dispozitave nuk bëhet pa e shoqëruar me ndërthurjen e interpretimit të tyre mbi faktin konkret, ose konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen.

Interpretimi i dispozitave materiale bëhet nga ana e gjyqtarit sipas mënyrës së interpretimit të tyre, në funksion të analizës juridike dhe të zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në këtë kontekst, konstatohet se gjyqtari kryesisht interpreton normën ligjore konkrete ndaj faktit juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, duke nxjerrë konkluzionin e tij në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:

Në vendimet e analizuara përgjithësisht, interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj, duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës, por në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi evidentohet interpretimi i dispozitave të caktuara të ligjeve dhe akteve nënligjore, të tilla si: dispozita të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2018, “Për pronësinë Industriale” (*vendimi nr.8250, datë 21.07.2014*), dispozita të Kodit të Punës lidhur me marrëdhënien e punës, shkaqet e justifikuara për zgjidhjen e marrëdhënies së punës (*vendimi nr. 10364, datë 29.10.2014*), dispozitat e Kodit Civil lidhur me shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror, si dhe dispozitat e ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” (*vendimi nr. 6741, datë 16.09.2015*), dispozita të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2018, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (*vendimi nr. 4490, datë 08.04.2014; vendimi nr. 322, datë 26.01.2015*), etj.

Në lidhje me interpretimin e dispozitave procedurale evidentohet se gjyqtari referon dhe citon dispozitat procedurale në vendimet civile të analizuara, duke i aplikuar mbi aspektet procedurale në funksion të të cilave ato referohen, pa u shoqëruar me interpretim të pavarur të kuptimit të tyre. Interpretimi i kufizuar i normave procedurale në vendimet civile të analizuara në rastin konkret duket se është kushtëzuar edhe nga objekti i mosmarrëveshjeve të trajtuara, të cilat nuk rezulton të kenë elementë apo aspekte procedurale të cilat janë vënë në diskutim, çka do të bënte të nevojshëm interpretimin e pavarur të dispozitave të caktuara procedurale.

Në vendimin penale të analizuar, (*kërkesën në fazën e hetimit paraprak*) rezulton se gjyqtari interpreton nenin 228 të K.Pr.Penale në lidhje me kushtet e përgjithshme dhe të posaçme për caktimin e masës së sigurimit personal ndaj të dyshuarit.

Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante. Evidentohet se gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante në mbështetje të argumenteve për interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij, në shumicën e vendimeve të analizuar. Konkretisht, në lidhje me: (i) me dyshimin e arsyeshëm, është referuar dhe analizuar, së bashku me bazën ligjore procedurale, Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 7, datë 14.10.2011;³ (ii) në lidhje me të drejtën e paditësit për disponimin lidhur me elementët e padisë (ndërgjyqësinë), gjyqtari është referuar në vendimin unifikues nr. 901, datë 14.07.2000, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;⁴ (iii) referon vendimin Unifikues nr. 12, datë 14.09.2007, të Gjykatës së Lartë, lidhur me dëmshpërblimin e dëmit jopasuror.⁵

Nga ana tjetër, nuk identifikohet referimi në jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare, si ajo e GJEDNJ-së, apo në legjislacionin e vendeve të tjera, por në vendimin nr. 20-2015-337/200, datë 10.04.2015, citohen Nenet 8 dhe 10 të Konventës Europiane për Mbrojtjen të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, në funksion të së drejtës për jetë private dhe të lirisë së shprehjes.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, në çdo rast janë respektuar me korrektësi aspektet e parimit të procesit të rregullt ligjor, duke referuar dhe interpretuar në disa raste, edhe aspekte të veçanta të këtij parimi të tilla si: parimi “gjë e gjykuar”, parimi procedural i disponibilitetit të palës paditëse në ndërtimin e ndërgjyqësisë, parimi i dhënies së drejtësisë sipas bindjes së brendshme, parimi i barrës së provës tek i padituri.⁶

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe kur është e nevojshme, në mbështetje të arsytimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

³ Vendimi nr. 887, datë 24.03.2015;

⁴ Vendimi nr. 322, datë 26.01.2015;

⁵ Vendimi nr.6741, datë 16.09.2015;

⁶ Vendimi nr. 10364, datë 29.10.2014.

1.B. ARSYETIMI LIGJOR

1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se *“Në të gjithë dokumentet dhe dosjet e vëzhguara gjyqtari përdor rregullisht të gjitha karakteret e gjuhës shqipe”*.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se vendimet gjyqësore janë të qarta dhe të kuptueshme, duke u bërë të kuptueshëm edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit.

Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe shmang përdorimin e fjalëve fyese apo denigruese.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës. Evidentohet në mënyrë të veçantë në të gjitha vendimet gjyqësore përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç).

Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente, vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh. në ligjet e posaçme të përdorura nga ana e gjykatës në lidhje me ligjin e zbatueshëm, apo në aktet e ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme, të ndryshme nga aktet juridike.

Në përdorimin e instituteve, parimeve, apo të drejtave të pjesëmarrësve në një procedim civil dhe penal, nuk rezulton përdorimi i termave latinisht,⁷ parimet apo institutet përdoren në gjuhën shqipe.

⁷ Është e diskutueshme nëse përdorimi i fjalëve në latinisht e rrisin apo jo vlerën e një vendimi gjyqësor, duke qënë se konsiderohet si “gjuhë e vdekur”, ndërkohë që vetë jurisprudenca ndërkombëtare kryesisht ajo e GJEDNJ-së shumë terma juridikë i përdor në gjuhën e vjetër latine. Pavarësisht këtij diskutimi, nëse do të konsiderohej vlerë, ajo do të duhej gjithmonë të shoqërohej me kuptimin e saj në gjuhën shqipe me qëllim që ky parim apo institut të bëhej i kuptueshëm edhe nga mosnjohësit e ligjit.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive me gjatësi normale, të ndërthurura dhe të kuptueshme. Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra tjetrës dhe paragrafët e arsyetimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi në lidhje me kuptimin e tyre, apo të kontekstit në të cilin përdoren. Vendimi është i organizuar me paragrafë, duke kaluar mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari ka aftësi të lartë të arsyetimit ligjor, në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRËORGANIZUAR E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “*Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi në arsyetimin ligjor me cilësi. Në dokumentin nr. 1 të paraqitur dhe dosjen nr.2 të vëzhguar ndiqet metoda e ndarjes së vendimit në pjesë: i) juridiksioni dhe kompetenca, ii) faktet objekt mosmarrëveshje, iii) pretendimet e palëve, iv) ligji i zbatueshëm, v) arsyetimi i gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Paragrafët e secilës nëndarje numërtohen rregullisht. Në 3 vendime të tjera megjithëse formalisht kjo ndarje nuk evidentohet, nga përmbajtja e vendimit rezulton se arsyetimi ndjek të njëjtin linjë me atë të ndarjes sipas pjesëve të cituara më lart (shih dokumentet 2 dhe 3 si dhe dosjen 1). Në 1 rast megjithëse nuk përdoret një metodologji e caktuar në arsyetimin e vendimit, konstatohet se vetë çështja paraqitet komplekse si përsa u përket numrit të çështjeve të bashkuara në një gjykim të vetëm (2 çështje), faktit i shqyrtimit edhe të një kundërpadië në proces ndaj një prej padive, fakti se çështja ishte rigjykim me detyra të përcaktuara dhe pjesë e arsyetimit janë edhe rezultat e akteve të ekspertimit, vendimi është i qartë, i kuptueshëm, i argumentuar, dhe arsyetimi është në nivelin e standardit të procesit të rregullt ligjor. Në çështjen penale të vëzhguar ku arsyetimi i vendimit paraqitet me tekst unik, gjykata parashtron rrethanat, analizohen provat si citohen përmbajtje të*

dispozitave procedurale penale përse u përket kushteve të flagrancës si dhe kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit (shih dosjen 5). Në një rast tjetër ku arsyetimi i vendimit paraqitet sërish me tekst unik, ai orientohet rreth mosezaurimit të të gjitha mënyrave të njoftimit nga shoqëria përmbartimore drejtuar debitorëve për t'iu drejtuar më pas gjykatës për caktim përfaqësuesi ligjor (shih dosjen 4)”.

Referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtari ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar në hartimin e vendimit, në përmbajtje të së cilës gjyqtari i referohet prezantimit të fakteve, pretendimeve të palëve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Konstatohet se vendimet civile përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile:

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënave lidhur me gjykatën, koha dhe vendi i zhvillimit të gjykimit, palët dhe përfaqësuesit e tyre, objekti dhe baza ligjore e padisë, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, në mënyrë të përmbledhur.

Në pjesën përshkruese-arsyetuese gjejnë pasqyrim: rrethanat e fakteve të çështjes, siç rezultojnë nga provat objekt shqyrtimi, parashtrimi në mënyrë të përmbledhur i pretendimeve të palëve, ku gjykata merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarit dhe konkluzionet e tij.

Pjesa e dispozitivit është e qartë, koncize, e thjeshtë dhe e kuptueshme, duke bërë të qarta disponimet e gjykatës lidhur me objektin e padisë, si dhe elementët e tjerë të vendimit lidhur me shpenzimet gjyqësore, të drejtën e ankimit, etj. Gjyqtari ndjek një strukturë pothuajse të njëjtë në paraqitjen e vendimeve përfundimtare, e cila është karakteristike e qëndrueshme e gjyqtarit, çka i bën vendimet e tij tepër të qarta dhe të kuptueshme.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se *“Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës në raport me objektin e mosmarrëveshjes. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka rritur gjyqtari. Ai tregon normën ligjore që zbatohet për faktet e mosmarrëveshjes, të përcaktuara sipas provave të shqyrtuara. Gjyqtari përdor gjerësisht përmbajtjen e dispozitave civile materiale dhe procedurale si dhe duke cituar dhe përdorur gjerësisht ligjet e posaçme (shih dokumentet 1, 2 dhe 3 si dhe dosjet nr. 1,2, 3 dhe 4). Gjyqtari i kushton kujdes përfshirjes në arsyetimin e vendimet përfundimtar të pretendimeve apo prapësimeve thelbësore të palëve si legjitimiteti i palëve në proces (shih dokumentet nr. 1, 2 dhe sosjen nr.1) apo rrëzimin e kërkesës për dhënie e vendimit për ekzekutim të përkohshëm (shih dosjen 3), arsyetimit të çdo pretendimi të paraqitur prej palëve në gjykim. Karakteristikë e gjyqtarit është përfshirja në arsyetimin e vendimit përfundimtar të vendimeve të ndërmjetime të gjykatës lidhur me ndryshimin e objekti të padisë (shih dokumentin 1), pranimin për shqyrtim të padisë së ndërhyrësit kryesor (shih dokumentin 2), bashkimin e padisë në një gjykim të vetëm (shih dosjen nr. 3). Nga pikëpamja formale, vendimet përfundimtare të tij plotësojnë, sipas rasantit, kërkesat e legjislacionit procedural penale apo kërkesat e legjislacionit procedural civil”*.

Referuar vendimeve gjyqësore objekt vlerësimi, evidentohet se në tërësi, në të gjitha aktet e analizuara rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, gjithnjë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale. Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material. Evidentohet kujdesi i gjyqtarit në arsyetim për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtari në çdo rast ka evidentuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e mosmarrëveshjes objekt gjykimi, duke orientuar analizën e koncepteve ligjore në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse.

Gjyqtari evidenton në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e mosmarrëveshjes objekt gjykimi, duke orientuar dhe analizën e koncepteve ligjore në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Konkretisht, pas interpretimit të dispozitës procedurale (neni 522 i K.Pr.Civile) në lidhje me *“Ekzekutimin ndaj debitorit që nuk i dihet banimi”*, gjyqtari argumenton se shoqëria përmbartimore nuk ka respektuar procedurën e njoftimit të debitorëve, përfshirë edhe njoftimin e tyre me shpallje. Vetëm pasi të jetë ezauruar e gjithë procedura e njoftimit të tyre, sipas neneve 133 dhe 144/a të K.Pr.Civile, gjen zbatim neni

522 i K.Pr.Civile për t'u emëruar debitorëve një përfaqësues ligjor, me qëllim vijimin e procedurave të ekzekutimit të titullit ekzekutiv.⁸

- Referuar kërkimit të palës paditëse, pas interpretimit të normës relevante mbi kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushë punëdhënësi për të proceduar me zgjidhjen e marrëdhënies së punësimit me punëmarrësin dhe referuar qëllimit të vetë dispozitës, gjyqtari arrin në konkluzionin se zgjidhja ka qenë e pajustificuar dhe për pasojë, pala paditëse duhet të dëmshpërblehet. Po kështu, për shkak të shpërblimit për vjetërsi, të parashikuar në nenin 145 të K.Punës, punëmarrësi duhet të dëmshpërblehet sipas parashikimeve ligjore.⁹

- Referuar pretendimeve të ngritura, gjyqtari, në interpretim të neneve 625, 608, dhe 646, të K.Civil, si dhe konkluzioneve të Vendimit Unifikues nr.12, datë 14.09.2007, ka konkluduar se pala paditëse duhet të përfitojë dëmshpërblimin jopasuror, në raport me masën e dëmit që ka pësuar, dhe nuk mund të përfitojë dëmshpërblim për dëm biologjik, pasi ky lloj dëmshpërblimi jepet vetëm në rastet e vdekjes apo të paaftësisë së përhershme e totale të personit. Konstatohet se niveli i arsytimit dhe përmbajtja e vendimit janë gjithëpërfshirës, duke u dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve dhe me rrjedhë logjike drejt konkluzionit të arritur.¹⁰

- Referuar kërkimit të palës paditëse për shpalljen e pavlefshmërisë (zhvlerësimit) të pjesshëm të markës të regjistruar nga i padituri, gjyqtari ndalet në kushtet që duhen plotësuar për zhvlerësimin e një marke dhe në mbështetje edhe të normave relevante (neneve 4, 159, 173 dhe 174 të ligjit të posaçëm nr. 9947, datë 07.07.2008, “Për pronësinë Industriale”) të konkludojë se neni 174/3 ndalon zhvlerësimin e markës kur ajo është në një formë, që ndryshon vetëm ato elemente të markës që nuk cenojnë karakterin dallues të saj, në formën që ajo është regjistruar, etj., ndaj duhet provuar mosekzistenca edhe e këtyre kushteve.¹¹

- Referuar pretendimeve të ngritur nga ana e palës paditëse, në interpretim të neneve 680, 700 dhe 750 të K.Civil, si dhe konkluzioneve të Vendimit Unifikues nr.1, datë 06.01.2009, gjyqtari argumenton se paditësi nuk ka interes “të godasë” një veprim juridik absolutisht të pavlefshëm, e as të kërkojë zgjidhjen e tij, pasi një veprim juridik absolutisht i pavlefshëm nuk mund të “zgjidhet”. Gjyqtari konkludon se padia objekt gjykimi ka vetëm një objekt të kërkueshëm, që është objekti për lirim e dorëzim sendi, duke qenë kjo një padi klasike reale, sipas nenit 296 të Kodit Civil.¹²

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Arsytimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse.

⁸ Vendimi nr. 4613, datë 10.04.2014;

⁹ Vendimi nr. 10364, datë 29.10.2014;

¹⁰ Vendimi nr. 6741, datë 16.09.2015;

¹¹ Vendimi nr. 8250, datë 21.07.2014;

¹² Vendimi nr. 324, datë 26.01.2015;

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarit”

| Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT | |
|--|-------|
| Niveli i vlerësimit | Pikët |
| Shkëlqyeshëm | 100 |

2. AFTËSIA ORGANIZATIVE E GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit {...} në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij, si kur gjykon i vetëm, ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Çështja që ka patur kohëzgjatjen më të ulët 1 ditë ka qënë çështje penale e natyrës urgjente, e përfunduar brenda afatit procedural të parashikuar nga neni 259/5 i K.Pr.Penale”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar vetëm 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, pa përfshirë tre vendimet e zgjedhura nga gjyqtari, në kushtet kur në ekstremitetet e vendimit nuk ka të dhëna lidhur me datën e regjistrimit të çështjes.

Në Kodin e Procedurës Civile në përgjithësi nuk parashikohet afat ligjor për përfundimin e gjykimit të çështjeve civile të themelit. Në lidhje me kërkesat me objekt “Emërim përfaqësuesi për debitorin”, neni 522 i K.Pr.Civile,¹³ parashikon shqyrtimin e tyre brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës në gjykatë. Në lidhje me çështjet me objekt “Kundërshtim veprimesh përmbarimore”, neni 610 i K.Pr.Civile parashikon shqyrtimin e tyre brenda 20 ditëve nga paraqitja e kërkesës në gjykatë.¹⁴ Në lidhje me kërkesat me objekt “Vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit”, neni 259 i K.Pr.Penale,¹⁵ parashikon shqyrtimin e tyre brenda dyzet e tetë orëve nga paraqitja e kërkesës në gjykatë.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se për 3 (tre) prej tyre parashikohet afat ligjor brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi i çështjes.

- Konkretisht, në çështjen me nr. 8842 vendimi, datë 13.11.2015, regjistruar në gjykatë në datën 23.09.2015, gjykimi ka përfunduar për 51 ditë, duke përfunduar jashtë afatit ligjor prej 20 ditësh, të parashikuar në nenin 610 të K.Pr.Civile.
- Në çështjen me nr. 4613 vendimi, datë 10.04.2014, regjistruar në gjykatë në datën 21.03.2014, gjykimi ka përfunduar për 20 ditë, duke përfunduar jashtë afatit ligjor prej 10 ditësh, të parashikuar në nenin 522 të K.Pr.Civile.
- Në çështjen me nr. 887 vendimi, datë 24.03.2015, regjistruar në gjykatë në datën 23.03.2015, gjykimi ka përfunduar për 1 (një) ditë, duke përfunduar brenda afatit ligjor prej dyzet e tetë orësh, të parashikuar në nenin 259/5 të K.Pr.Penale.

Në lidhje me çështjen e përfunduar me vendimin nr. 4613, datë 10.04.2014, e cila është gjykuar për 20 ditë, rezulton se data e regjistrimit të çështjes në gjykatë 21.03.2014, nuk mund të barazohet me datën kur dosja i ka kaluar gjyqtarit për veprim. Nga momenti kohor i marrjes së dosjes, duke llogaritur edhe nevojën e njoftimit të kërkuarit me letërthirrje, është caktuar seanca gjyqësore në datën më të parë të mundshme, që ka qenë data 08.04.2014. Në këtë datë, kërkesa

¹³ Neni 522 i K.Pr.Civile parashikon se “Kur banimi i debitorit nuk dihet, gjykata e shkallës së parë e vendit të ekzekutimit, me kërkesën e përmbaruesit gjyqësor, pasi sqarohet edhe vetë për këtë rrethanë, brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së përmbaruesit gjyqësor i emëron debitorit një përfaqësues, i cili shpërblehet fillimisht nga kreditori sipas nenit 525 të këtij Kodi.”.

¹⁴ Neni 610 i K.Pr.Civile “...Ankimi shqyrtohet brenda 20 ditëve nga gjykata e vendit të ekzekutimit, e cila kur e sheh të nevojshme mund të thërrasë edhe palët”.

¹⁵ Neni 259 i K.Pr.Penale parashikon se “...5. Arrestimi ose ndalimi e humbet fuqinë kur vendimi i gjykatës për vleftësimin nuk është shpallur brenda dyzet e tetë orëve të ardhshme nga çasti në të cilin kërkesa e prokurorit është paraqitur në gjykatë”.

është konstatuar me të meta, konform nenit 154/a të K.Pr.Civile, duke mbetur pa veprime. Në vijim edhe seanca e lënë një ditë më pas, më 09.04.2014 është shtyrë, duke zgjatur afatin për plotësimin e të metave, ndërsa gjykimi ka përfunduar në datën 10.04.2014.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar edhe akteve të dorëzuara nga gjyqtari, nëse në llogaritjen e raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor nuk do të përfshihej çështja e mësipërme, në të cilën situata procedurale nuk ka qenë përgjegjësi e gjyqtarit, atëherë, duke iu referuar çështjeve për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, rezulton se për 1 (një), nga 3 (tre) prej tyre, ose 33% të tyre vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor.

KONKLUZIONI

Në kushtet kur të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar çështjeve të analizuara më sipër, ngarkesës së gjyqtarit për vitin 2014 (*caktuar 531 çështje, përfunduar 473 çështje*) dhe vitin 2015 (*caktuar 609 çështje, përfunduar 517 çështje*) për këtë tregues, gjyqtari pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi se përqindja e shqyrtuar jashtë afatit ligjor, e cila rezulton të jetë 33%. Për pikëzimin e këtij treguesi, vlerësuesi bazohet në parimin e proporcionalitetit, objektivitetit, përballë detyrueshmërisë ligjore që një kategori çështjesh duhet të shqyrtohen brenda afateve të përcaktuara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Respektimi i afateve ligjore”, duke pasur parasysh edhe shkaqet që kanë ndikuar në këtë tregues, gjyqtari vlerësohet “21-30%”, duke e pikëzuar me 9 pikë.

2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit

për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 8¹⁶ çështjeve të përzgjedhura me short, pa përfshirë tre vendimet e zgjedhura nga gjyqtari, në kushtet kur në ekstremitetet e vendimit nuk ka të dhëna lidhur me datën e regjistrimit të çështjes.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se *“Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për efekt të organizimit të shorit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016, gjyqtari {...} i seksionit civil ka përfunduar gjithsej 1459 çështje gjyqësore, nga të cilat 667 çështje civile themeli me palë kundërshtarë (658 civile të përgjithshme, dhe 9 tregtare) dhe 792 çështje pa palë kundërshtarë (235 masa sigurimi dhe kërkesa penale si dhe 557 kërkesa civile). Sipas pikës 3 shkronja “e”, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë i dhomës civile si relator i seksionit të përgjithshëm, duhet të ketë në jo më pak se 120 çështje civile me palë kundërshtar. Ky rregull nënkupton një ngarkesë sasiore prej jo më pak se 360 gjykime çështjesh të tilla për tre vjet. Duke zbatuar këtë rregull në rastin e subjektit të rivlerësimit {...} konstatohet se ngarkesa e tij sasiore ka qënë mbi standardin sasior. Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari {...} ka qënë në intervale kohore nga 1 ditë (shih dosjen 5) deri në 1 vit, 9 muaj e 23 ditë (shih dosjen 3). Çështja, që ka patur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit ka qënë çështje në rigjykim ku janë bashkuar në të njëjtin gjykim 2 çështje si dhe është gjykuar edhe një kundërpadi përkatësisht me objekt: njohje pronar, lirim dhe dorëzim sendi dhe pavlefshmëri kontrate e cila është shqyrtuar në 26 seanca (7 përgatitore dhe 19 gjyqësore), kohëzgjatje në të cilën kryesisht ka ndikuar njoftimi ndaj palëve ndërgjyqëse të cilat rezultojnë të jenë në numër të lartë, si dhe marrja e provës me ekspert nga 2 fusha të ndryshme. Ndër 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se në 2 raste është konstatuar tejkalimi i afatit standard të gjykimit i vendosur nga KLD (shih dosjet 1 dhe 3), 1 prej të cilave tejkalimi i afatit është i papërfillshëm me vetëm 1 ditë”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, evidentohet se për çështjet e vëzhguara, gjykimi ka zgjatur përgjithësisht brenda standardeve minimale kohore, sipas Vendimit nr.261/2 të KLD, dhe duke i ndarë sipas kategorisë së çështjeve rezultojnë se:

Çështje tregtare:

- Dosja 1 - (është caktuar me short në datën 25.07.2014 dhe ka përfunduar në datën 26.01.2015) Gjykimi ka zgjatur 6 muaj e 1 ditë, duke e tejkeluar vetëm me një ditë afatin 6 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet tregtare;
- Dosja 7 - (është caktuar me short në datën 16.07.2013 dhe ka përfunduar në datën 21.07.2014) Gjykimi ka zgjatur 1 vit e 5 ditë, tej afatit 6 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet tregtare. Nëse afatit tërësor të kohëzgjatjes së gjykimit do t'i zbritej kohëzgjatja e gjykimit për efekt të kryerjes së veprimeve procedurale (njoftimi i të paditurit nëpërmjet kërkesës për ndihmë juridike 16.10.2013-30.05.2014, e cila në tërësi ka zgjatur për rreth 7 muaj e 14 ditë), atëherë gjykimi do të kishte përfunduar për një periudhë prej 4 muaj e 21 ditë. Pra brenda afatit 6 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet tregtare.

¹⁶ Nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykim, konkretisht dosja 4, 5 dhe 11

Çështje civile:

- Dosja 2 - (është caktuar me short në datën 06.11.2013 dhe ka përfunduar në datën 27.01.2014) Gjykimi ka zgjatur 2 muaj e 21 ditë, brenda afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Dosja 3 - (është caktuar me short në datën 25.03.2014 dhe ka përfunduar në datën 18.01.2016) Gjykimi ka zgjatur 1 vit e 9 muaj e 23 ditë, tej afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Dosja 6 - (është caktuar me short në datën 23.06.2014 dhe ka përfunduar në datën 29.10.2014) Gjykimi ka zgjatur 4 muaj e 6 ditë, brenda afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Dosja 8 - (është caktuar me short në datën 08.05.2014 dhe ka përfunduar në datën 26.01.2015) Gjykimi ka zgjatur 5 muaj e 23 ditë (pa përfshirë këtu periudhën e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë lidhur me moskompetencën 16.09.2014-10.12.2014), brenda afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Dosja 9 - (është caktuar me short në datën 15.10.2014 dhe ka përfunduar në datën 16.09.2015) Gjykimi ka zgjatur 11 muaj e 1 ditë, tej afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile.
- Dosja 10 - (është caktuar me short në datën 02.12.2014 dhe ka përfunduar në datën 01.12.2015) Gjykimi ka zgjatur 11 muaj e 29 ditë, tej afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile.

Çështja me nr. 1793 vendimi, datë 09.03.2015, trajtuar në vendimin nr. 2518/1 Prot., datë 03.06.2021 të ILD-së, për shkak të ankesës së shtetases K.T., për zvarritje të gjykimit, referuar nenit 91 të Ligjit për Statusin, nuk do të merret në vlerësim për shkak se në këtë çështje gjyqtari ka qenë në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, jo të relatorit, duke mos qenë përgjegjës për kohëzgjatjen e gjykimit.

Duke iu referuar raportit të numrit të çështjeve për të cilat gjykimi ka përfunduar tej standardit minimal kohor, në raport me numrin e çështjeve të analizuara¹⁷ (3/8) rezulton së çështjet e shqyrtuara në tejkallim të standardit minimal kohor, përbëjnë mbi 37.5 % të tyre.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe analizës së mësipërme lidhur me afatin e gjykimit të çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, raportit të këtyre çështjeve me numrin total të çështjeve që rezulton në masën 37.5%, si dhe shkaqeve që ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimit sipas burimeve të vlerësimit, shkaqe të cilat nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, por për shkaqe objektive që lidhen me ecurinë e procesit, respektimin e të drejtave të palëve, njoftimin e tyre etj., ky tregues pikëzohet në nivelin maksimal të tij.

¹⁷ Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Respektimi i standardeve minimale kohore” aftësia e gjyqtarit vlerësohet “0-10 %”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJEJE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari {...} ka qënë në intervale kohore nga 1 ditë (shih dosjen 5) deri në 1 vit, 9 muaj e 23 ditë (shih dosjen 3). Çështja, që ka patur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit ka qënë çështje në rigjykim ku janë bashkuar në të njëjtin gjykim 2 çështje si dhe është gjykuar edhe një kundërpadi përkatësisht me objekt: njohje pronar, lirim dhe dorëzim sendi dhe pavlefshmëri kontrate e cila është shqyrtuar në 26 seanca (7 përgatitore dhe 19 gjyqësore), kohëzgjatje në të cilën kryesisht ka ndikuar njoftimi ndaj palëve ndërgjyqëse të cilat rezultojnë të jenë në numër të lartë, si dhe marrja e provës me ekspert nga 2 fusha të ndryshme”.

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 8 (tetë) çështjeve të përzgjedhura me short, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, jo afati ligjor i gjykimit.¹⁸

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, në raport me standardin minimal kohor për çdo kategori (nga 8 çështjet e marra në analizë, 6 janë çështje civile themeli, 2 çështje tregtare), rezulton se:

¹⁸ Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se :” Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi”.

- (i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 6 (gjashtë) çështje në kategorinë e çështjeve “Civile të përgjithshme”, rezulton të jetë 288 ditë, rreth 9 muaj e 18 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal për gjykimin e çështjeve civile të themelit në Gjykatën e Shkallës së Parë.¹⁹
- (ii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 2 (dy) çështje në kategorinë e çështjeve “tregtare”, rezulton të jetë 161 ditë, rreth 5 muaj e 11 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal për gjykimin e çështjeve tregtare në Gjykatën e Shkallës së Parë.²⁰

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara është më e gjatë se standardi minimal kohor për gjysmën e kategorive të çështjeve, por nga analiza logjike (jo matematikore) e të dhënave statistikore, referuar ngarkesës në punë të gjyqtarit dhe numrit të çështjeve të përfunduara, pikëzimi për këtë kriter është maksimal. Nga ana tjetër, referuar dosjeve burim vlerësimi, angazhimi i gjyqtarit në përfundimin në kohë të çështjeve është maksimal, por ka qenë ecuria procedurale e tyre që ka kushtëzuar përfundimin e çështjeve tej standardit minimal.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, gjyqtari pikëzohet me 5 pikë.

2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me rendimentin e përfundimit të çështjeve konkludohet se: “...Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna, është 84.2%...”.

Për periudhën e vlerësimit gjyqtarit {...}:

¹⁹ Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “ e. Gjykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshme, jo më tej se 6 muaj”.

²⁰ Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “d. Gjykimet e mosmarrëveshjeve familjare në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 4 muaj”.

- Për vitin 2013, i janë caktuar për shqyrtim 399 çështje të reja (365 çështje civile, 33 masa sigurimi dhe 1 kërkesë penale), ka përfunduar 286 çështje (252 çështje civile, 33 masa sigurimi dhe 1 kërkesë penale).
- Për vitin 2014, i janë caktuar për shqyrtim 531 çështje të reja (473 çështje civile dhe 58 masa sigurimi), ka përfunduar 434 çështje (376 çështje civile dhe 58 masa sigurimi).
- Për vitin 2015, i janë caktuar 609 çështje të reja (512 çështje civile, 96 masa sigurimi dhe 1 kërkesë penale), ka përfunduar 517 çështje (420 çështje civile, 96 masa sigurimi dhe 1 kërkesë penale)
- Për vitin 2016 (01.01.2016-08.11.2016), i janë caktuar 375 çështje të reja (298 çështje civile, 74 masa sigurimi dhe 3 kërkesë penale), ka përfunduar 374 çështje (297 çështje civile, 74 masa sigurimi dhe 3 kërkesë penale) (*sipas Raportit të analizimit të aftësive profesionale, faqe 3*).

Nga statistikat e mësipërme rezulton se gjyqtari {...} ka përfunduar në gjithë periudhën e vlerësimit, sipas tabelave me të dhëna statistikore të administruara në faqen 104-129 të dosjes së rivlerësimit, 1459 çështje, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Duke qenë se ka mungesë të dhënash në tabelat me të dhëna statistikore për çështjet e caktuara gjatë periudhës së vlerësimit, mbetet e pamundur përlllogaritja e rendimentit sipas të dhënave statistikore që administrohen në dosje, e për rrjedhojë, do të merret i mirëqenë rendimenti 84.2% i përcaktuar në faqen 36 të Raportit, faqja 2350 e dosjes së rivlerësimit.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarit për periudhën e plotë të vlerësimit rezulton në masën 84,2%. Duke pasur parasysh Metodologjinë e Pikëzimit, ku përcaktohet se “*gjyqtari që ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës për përcaktuara*”, për gjyqtarin {...} rezulton se standardi sasior i punës është tejkaluar dukshëm me më shumë se 50%, (*gjyqtari i shkallës së parë, i dhomës civile, si relator, jo më pak se 120 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare, ndërkohë që gjyqtari për vitin 2014 ka përfunduar 223 çështje më palë kundërshtare, pa përfshirë këtu kërkesat civile; për vitin 2015 ka përfunduar 208 çështje me palë kundërshtare, pa përfshirë këtu kërkesat civile dhe për vitin 2016 (deri në 08.10.2016) ka përfunduar 156 çështje me palë kundërshtare, pa përfshirë këtu kërkesat civile*), prandaj aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet në nivelin “Mbi 87-93%”, duke u pikëzuar me 6 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” është “Mbi 87-93%”, duke e pikëzuar me 6 pikë.

2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë

periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në kryesekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short);
- Informacioni i përcjellë nga gjykata²¹ lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se *“Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtari {...} i kushton rëndësi arsyetimit në kohë të shpejtë të vendimeve. Në 4 nga 5 raste të vëzhguara arsyetimi i vendimeve është brenda afatit procedural civil apo penal. Konkretisht arsyetimi rezulton të jetë kryer për 3 ditë nga shpallja (shih dosjen 5), për 4 ditë (shih dosjen 4), për 7 ditë (shih dosjen 2) dhe për 8 ditë (shih dosjen 1). Vendimi për dosjen nr.3 është dorëzuar për 4 ditë por nisur nga fakti se seanca e parafundit gjyqësore është shtyrë për shpalljen e vendimit, ai nuk rezulton të jetë shpallur i arsyetuar sipas parashikimeve të nenit 308 të K.Pr.Civile, ndërsa rezulton se është shpallur brenda afati 10 ditor të parashikuar në këtë dispozitë. Duket se ka ndikuar kompleksiteti i çështjes. Në këto të dhëna mbahet në konsideratë dhe ngarkesa mbi standardet e përballuar nga gjyqtari”*.

Në Kodin e Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve me Ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 10 (dhjetë) ditor, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë, kur palët ishin prezent, fillonte nga dita e shpalljes së vendimit. Në këto kushte, në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 10 ditor i ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

²¹ Informacioni i dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nëpërmjet postës elektronike në datën 09.10.2020.

- Dosja 1 (*çështje tregtare*), që i përket vendimit me nr. 322 datë 26.01.2015, është dorëzuar në datën 03.05.2015 - (8 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.
- Dosja 2 (*çështje civile*), që i përket vendimit me nr. 908, datë 27.01.2014, është dorëzuar në datën 03.02.2014 - (7 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.
- Dosja 3 (*çështje civile*), që i përket vendimit me nr. 107, datë 18.01.2016, është dorëzuar në datën 22.01.2016 - (4 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.
- Dosja 4 (*çështje civile*), që i përket vendimit me nr. 4613, datë 10.04.2014, është dorëzuar në datën 14.04.2014 - (4 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.
- Dosja 5 (*kërkesë penale*), që i përket vendimit me nr. 887, datë 24.03.2015, është dorëzuar në datën 27.03.2015 - (3 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.

Sipas informacioneve të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nëpërmjet postës elektronike të datës 09.10.2020, lidhur me 6 (gjashtë) nga dosjet e përzgjedhura me shortin e datës 15.09.2020, rezulton se:

- Dosja 6 (*çështje civile*), që i përket vendimit me nr. 10364, datë 29.10.2014, është dorëzuar në datën 04.11.2014 - (6 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.
- Dosja 7 (*çështje tregtare*), që i përket vendimit me nr.8250, datë 21.07.2014, është dorëzuar në datën 29.07.2014 - (8 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.
- Dosja 8 (*çështje civile*), që i përket vendimit me nr.324, datë 26.01.2015, është dorëzuar në datën 03.02.2015 - (8 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.
- Dosja 9 (*çështje civile*), që i përket vendimit me nr. 9381, datë 01.12.2015, është dorëzuar në datën 10.12.2015- (9 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.
- Dosja 10 (*çështje civile*), që i përket vendimit me nr.6741, datë 16.09.2015, është dorëzuar në datën 25.09.2015 - (9 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.
- Dosja 11 (*çështje civile*), që i përket vendimit me nr. 8842, datë 13.11.2015, është dorëzuar në datën 20.11.2015- (7 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.

Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se koha e arsyetimit të vendimit për kategorinë *kërkesa penale*, për 1 dosje është 3 ditë. Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit për kategorinë *civile themeli*, për 8 dosje është 6.7 ditë. Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt

shqyrtimi, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit për kategorinë çështje tregtare, për 2 dosje është 8 ditë.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar rezulton “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” është “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JO-PRODUKTIVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Ndër 5 çështjet e shortuara, janë vëzhguar gjithsej 41 seanca të zhvilluara prej saj nga të cilat 21 seanca, ose rreth 50% kanë qënë joproduktive për: i) për mosnjoftimin e palëve në 11 raste, ii) për realizimin e të drejtës së përfaqësimit në 1 rast: iii) për shkak të pjesëmarrjes në gjykime të tjera të përfaqësuesve të palëve në 3 raste, iv) për plotësim të metash të padisë në 3 raste, v) për njoftimin e eksperteve në 2 raste vi) për shpalljen e vendimit përfundimtar në 1 rast. Planifikimi i seancave gjyqësore nga gjyqtari {...} kryesisht është në afate normale. Nga vëzhgimi i 41 seancave, në 8 raste planifikimi i tyre është realizuar mbi 30 ditë konkretisht : 1 muaj dhe 1 ditë, 1 muaj dhe 2 ditë, 1 muaj dhe 4 ditë, 1 muaj dhe 5 ditë, 1 muaj dhe 8 ditë, 1 muaj dhe 11 ditë, 2 muaj dhe 2 muaj dhe 2 ditë. Në disa raste të planifikimit të seancave në këto afate ka ndikuar edhe periudha e lejes vjetore të gjykatës. Planifikimi i seancave të tjera civile është nën 30 ditë. Në çështjen penale të vëzhguar

planifikimi i seancës dhe zhvillimi i gjykimit është në respektim të afatit procedural penale prej 48 orë (shih dosjen 5). Në tërësi, gjyqtari ka mbikëqyrur kryerjen e njoftimeve nga sekretaria gjyqësore, ndërsa shtyrja e gjykimeve ka ndodhur për shkaqe procedurale sikundërse është njoftimi i tyre”.

Nga 11 çështjet e përzgjedhura për vlerësim, lidhur me numrin e seancave gjyqësore të gjitha çështjet vlerësohen si çështje me palë kundërshtare për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit (me përjashtim të dosjes nr. 1, që i takon kategorisë kërkesa penale në fazën e hetimeve paraprake).

❖ Në çështjet e përzgjedhura me short, administruar në dosjen e rivlerësimit konstatohet se:

- Dosja 1 – që i përket çështjes tregtare, me nr. 1929 regjistri, datë regjistrimi 24.07.2014, me objekt “Largimin si ortak nga shoqëria”, përfunduar me vendimin nr. 322, datë 26.01.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore, nga të cilat 1 (një) seancë ka rezultuar joproductive, e cila është shtyrë për shkaqe procedurale, për realizimin e të drejtës së përfaqësimit nga pala paditëse.
- Dosja 2 – që i përket çështjes civile, me nr. 6035 regjistri, datë regjistrimi 05.11.2013, me objekt “Pushim cenimi në posedim”, përfunduar me vendimin nr.908, datë 27.01.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 3 (tre) seanca gjyqësore, nuk rezulton të ketë seanca joproductive.
- Dosja 3 – që i përket çështjes civile, me nr. 352 regjistri, datë regjistrimi 24.03.2015, përfunduar me vendimin nr.107, datë 18.01.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 19 (nëntëmbëdhjetë) seanca gjyqësore, nga të cilat 8 (tetë) seanca ka qenë joproductive, 2 (dy) seanca për shkak të mosnjoftimit të palëve në gjykim dhe Avokaturës së Shtetit; 3 (tre) seanca janë shtyrë me kërkesë të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse; 2 (dy) seanca për njoftimin e ekspertëve; 1 (një) seancë për plotësimin e të metave të kundërpadisë. Evidentohet se çështja ka qenë komplekse për shkak se në gjykim janë bashkuar 2 (dy) kërkesëpadi, si dhe është gjykuar një kundërpadi në lidhje me padinë e parë. Po kështu, çështja rezulton të jetë gjykuar në rigjykim nga gjyqtari {...}, me detyra të përcaktuara nga gjykata e apelit.
- Dosja 4 – që i përket çështjes civile, me nr. 9370 regjistri, datë regjistrimi 21.03.2014, me objekt “Emërim përfaqësuesi për debitorin”, përfunduar me vendimin nr.4613, datë 10.04.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 3 (tre) seanca gjyqësore, nga të cilat 2 (dy) kanë qenë seanca joproductive.

❖ Në çështjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit konstatohet se:

- Dosja 6 – që i përket çështjes civile, me nr. 12047 regjistri, datë regjistrimi 20.06.2014, me objekt “Padi marrëdhënie pune”, përfunduar me vendimin nr.10364, datë 29.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jetë zhvilluar 1 (një) seancë gjyqësore, e cila ka rezultuar produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar.
- Dosja 7 – që i përket çështjes tregtare, me nr.15832/4138 regjistri, datë regjistrimi 15.07.2013, me objekt “Pavlefshmëri (zhvlerësim) të pjesshëm të markës” përfunduar me vendimin nr. 8250, datë 21.07.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë

zhvilluar 4 (katër) seanca gjyqësore, nga të cilat 1 (një) seancë ka qenë joproductive, e cila nuk është zhvilluar për shkak të mosformimit të trupit gjykues.

➤ Dosja 8 – që i përket çështjes civile, me nr. 10739 regjistri, datë regjistrimi 08.05.2014 me objekt “Zgjidhje e akt marrëveshjes dhe lirim e dorëzim apartamenti”, përfunduar me vendimin nr.324, datë 26.01.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 4 (katër) seanca gjyqësore, nga të cilat 1 (një) seancë ka qenë joproductive, e cila nuk është zhvilluar për shkak të mosformimit të trupit gjykues.

➤ Dosja 9 – që i përket çështjes civile, me nr. 14611 regjistri, datë regjistrimi 14.10.2014, me objekt “Shpërblimin e plotë të dëmit pasuror dhe jopasuror” përfunduar me vendimin nr.6741, datë 16.09.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 11 (njëmbëdhjetë) seanca gjyqësore, nga të cilat 2 (dy) seanca kanë qenë joproductive, një seancë nuk është zhvilluar për shkak të mosformimit të trupit gjykues dhe një seancë për mosparaqitjen e ekspertit.

➤ Dosja 10 – që i përket çështjes civile, me nr. 16105 regjistri, datë regjistrimi 01.12.2014, me objekt “Detyrim njohje pronar”, përfunduar me vendimin nr. 9381, datë 01.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 10 (dhjetë) seanca gjyqësore, nga të cilat 3 (tre) seanca kanë qenë joproductive, për shkak të mosparaqitjes të palës paditëse dhe palës së paditur.

➤ Dosja 11 – që i përket çështjes civile, me nr. 11921 regjistri, datë regjistrimi 22.09.2015, me objekt “Kundërshtim i veprimeve përmbartimore”, përfunduar me vendimin nr. 8842, datë 13.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore. Nuk ka seanca joproductive.

Nga tërësia e të dhënave si më sipër, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtari në 10 çështjet e vëzhguara me palë kundërshtare (civile me palë kundërshtare dhe çështje tregtare) varion nga 1 deri në 19 seanca. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 5.8 seanca gjyqësore. Nëse nga kjo përlllogaritje do të përjashtoheshin 19 seancat e zhvilluar gjatë gjykimit të çështjes që i përket dosjes 3, e cila ka zgjatur në kohë për shkaqe procedurale që nuk varen nga gjyqtari, analizuar më sipër në raport, numri mesatar i seancave gjyqësore për 9 çështjet e mbetura, rezulton të jetë 4.3 seanca.

Sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive, duke iu referuar akteve të dosjeve të përzgjedhura me short, rezulton se:

- Gjyqtari ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët;
- Në çështjet në të cilat seancat gjyqësore nuk janë çelur për shkak të mosformimit të trupit gjykues (*gjyqtari ndodhej në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër në një gjykim penal*), rezulton që seancat vijuese të jenë planifikuar në një kohë të afërt dhe janë marrë masa efektive për të siguruar vijimin pa vonesa të gjykimit;
- Në të gjitha rastet e tjera, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale, të tilla si: garantimi i procesit të rregullt, përsëritja e njoftimit për të paditurin, duke njoftuar përfaqësuesin e tij ligjor, sipas ekstraktit zyrtar, duke bërë çdo përpjekje për të njoftuar efektivisht këtë palë; dhënia kohë palëve për të paraqitur prova në dobi të gjykimit; njoftimi i ekspertit të caktuar nga gjykata; lënia kohë ekspertit për të përgatitur aktin e ekspertimit apo shtesën e aktit të ekspertimit; mosparaqitja e ekspertit; lenia kohë palëve të njihen me aktin e

ekspertimit apo me shtesën e aktit të ekspertimit; lënia kohë palës paditëse për të saktësuar vlerën e objektit të padisë; përgatitja me shkrim e pretendimeve përfundimtare; shpallja e vendimit përfundimtar;

- Përgjithësisht seancat gjyqësore janë planifikuar brenda një afati të arsyeshëm, nën 30 ditë. Në disa raste kur ky afat është kaluar, ka ndikuar leja vjetore e gjyqtarëve në muajin gusht, apo komunikimi i akteve ndërmjet kërkesës për ndihmë juridike.

Referuar sa më sipër, për treguesit e “*Numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 10 çështjeve²² me palë kundërshtarë të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 4.3 seanca. Pavarësisht numrit mesatar të seancave, gjyqtari në çdo rast ka treguar kujdes, duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet. Shkaqet e shtyrjeve lidhen me kryerjen e veprimeve procedurale të domosdoshme për procesin e rregullt ligjor.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, pavarësisht se numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave joproduktive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, prandaj gjyqtari vlerësohet me 15 pikë

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me këtë tregues, pavarësisht se numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave joproduktive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, prandaj gjyqtari vlerësohet me 15 pikë.

2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

²² Referuar Metodologjisë së Pikëzimit “*Për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përcakton fillimisht numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh (civile, administrative, penale, dhe sipas shkallëve të gjykimit), duke përjashtuar ato pa palë ndërgjyqëse*”.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se *“Në tërësi, gjyqtari ka mbikëqyrur kryerjen e njoftimeve nga sekretaria gjyqësore, ndërsa shtyrja e gjykimeve ka ndodhur për shkaqe procedurale sikundërse është njoftimi i tyre. Në dosjet e vëzhguara, seancat gjyqësore jo gjithmonë dokumentojnë vendin e zhvillimit të gjykimit, ndërsa vetëm 12 prej tyre dokumentohen edhe me regjistrim audio, në funksion të solemnitetit dhe të transparencës së gjykimit (shih dosjet 1, 2 dhe 3). 5 seanca të vëzhguara rezultojnë të jenë çelur me vonesë 3 prej të cilave në intervale kohore 5-9 minuta. Në rast 1 tjetër vonesa është 19 minuta dhe shkaku i dokumentuar rezulton të jetë planifikimi dy gjykimeve në të njëjtën orë (shih dosjen 2), ndërsa vonesa tjetër është 35 minuta ku shkaku i vonesës nuk dokumentohet, por nga akti i njoftimit rezulton se janë njoftuar për seancë në të njëjtën ditë dhe orë 9 persona nën hetim ku nga aktet e dosjes nuk rezulton të jetë procedim i lidhur (shih dosjen 5). Gjatë gjykimit, gjyqtari {...} identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe zhvillon siç duhet procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve, prezantimin e gjykatës, debatin dhe hetimin gjyqësor, pohimet e palëve, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve gjer në shpalljen e vendimit”.*

Nga çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, rezulton se çështjet i përkasin kategorisë së çështjeve civile të përgjithshme me palë kundërshtare, çështje tregtare dhe kërkesa në fazën e hetimit paraprak.

Gjyqtari përgjithësisht i ka vënë në lëvizje çështjet, duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore në çështjet civile. Në çdo rast, çështja është vënë në lëvizje, duke filluar që nga brenda ditës (dosja 5), deri 6 ditë pas caktimit të çështjes me short. Seancat përgatitore dhe ato gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës të mbajtur nga sekretarja gjyqësore, në disa raste procesverbali është mbajtur edhe me sistemin e regjistrimit audio.

Rezulton që seancat gjyqësore të jenë zhvilluar në mënyrë korrekte, duke ndjekur ecurinë procedurale sipas dispozitave të K.Pr.Civile dhe duke pasqyruar veprimet e kryera për verifikimin e paraqitjes së palëve dhe përfaqësuesve të tyre, relatimin e akteve të njoftimit dhe marrjen ose jo dijani nga palët që nuk janë paraqitur, disponimin me vendim të ndërmjetëm për zhvillimin e gjykimit në mungesë, në rastet e mosparaqitjes së palëve pa shkaqe të përligjura, shpalljen e trupit gjykues, dhënien e fjalës palëve për kërkesa paraprake, disponimin me vendim për kërkesat paraprake të palëve në rastet kur paraqiten kërkesa të tilla, deklarin të hapur të shqyrtimit gjyqësor, dhënien e fjalës palëve për paraqitjen e parashtrimeve dhe provave, administrimin e provave, drejtimin dhe orientimin e debatit mbi provat, si dhe mbi elementë proceduralë të zhvillimit të gjykimit, dhënien e fjalës palëve lidhur me vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor pas zhvillimit të debatit mbi provat, deklarin e mbyllur të shqyrtimit gjyqësor, dhënien e fjalës palëve për paraqitjen e diskutimit përfundimtar, tërheqjen e gjykatës për marrjen e vendimit dhe shpalljen e vendimit përfundimtar.

Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se dosjet janë renditura në mënyrë të rregullt, duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e dosjeve ndjek kryesisht të njëjtën linjë në të 11 dosjet e vëzhguara, duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre.

Renditja e dosjes në çështjet civile fillon me padinë dhe provat e paraqitura nga palët, vijon me vendimin e gjyqtarit për caktimin e seancës përgatitore, aktet e njoftimit të palëve, procesverbalet e seancave përgatitore, kërkesat dhe parashtrimet me shkrim të palëve gjatë gjyqimit, procesverbalet e seancave gjyqësore dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave. Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë aftësi shumë të lartë në këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short është konstatuar përgjithësisht aktet themelore janë të rregullta, të sakta dhe të plota. Procesverbali gjyqësor dokumenton kohën dhe vendin, si dhe veprimet që kryhen në seancë. Në të 5 dosjet gjyqësore janë përfshirë rregullisht padia dhe provat e paraqitura nga

paditësi në procesin civil apo kërkesa e të arrestuarit dhe provat përkatëse, aktet e njoftimit të palëve; kërkesat me shkrim të palëve dhe provat e paraqitura prej tyre; procesverbali përgatitor dhe ai gjyqësor, vendimi gjyqësor dhe urdhri i ekzekutimit kur ai është lëshuar nga gjykata. Megjithatë janë vërejtur edhe mangësi në këtë drejtim pasi në 2 nga 5 raste mungon vendimi për caktimin e seancës përgatitore (shih dosjet nr3 dhe 4) dhe në 1 rast mundon vendimi për caktimin e seancës gjyqësore (shih dosjen nr. 5). Në rastin e dosjes nr.5 mungojnë gjithashtu akti për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes si dhe akti i njoftimit të prokurorit, ndërsa kjo mangësi e fundit nuk ka sjellë pasoja në gjykim pasi prokurori ka qënë i pranishëm dhe seanca është zhvilluar normalisht. Vendimet e ndërmjetëm janë fiksuar gjithnjë në procesverbal, janë të arsyetuara rregullisht dhe përgjithësisht citojnë shkakun ligjor”.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, për saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se në dosje ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo seancë, procesverbalet e çdo seancë përgatitore apo gjyqësore, vendimet gjyqësore), si dhe aktet e paraqitura nga palët (padiat, provat, prapësimet, kërkesat dhe konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim). Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” është “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.*

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive organizative të gjyqtarit”

| Niveli i vlerësimit | |
|------------------------------------|-------|
| KRITERI | |
| AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT | |
| Niveli i vlerësimit | Pikët |
| Shkëlqyeshëm | 90 |

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq

paanësi në funksion. Pikëzimi për treguesit e këtij kriteri bëhet në rend zbritës, dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar këtij kriteri vlerësimi, duke zbritur sipas rasisit pikët në varësi të problematikave të shfaqura në lidhje me çdo tregues sipas burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezultojnë se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013-8 tetor 2016”, për gjyqtarin {...} janë paraqitur 9 ankesa (1 në vitin 2013, 6 në vitin 2014m dhe 2 në vitin 2016) në Inspektoratin e KLD-së. 4 ankesa (3 të vitit 2014, 1 e vitit 2016) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar ndër të cilat 2 ankesa me arsyetimin se pretendimet zgjidhjen përmes apelimit gjyqësor dhe 2 ankesa me arsyetimin se janë ankesa të përsëritura më parë. 5 ankesa janë verifikuar dhe rezultatet janë si më poshtë:

- 1 ankesë e vitit 2013 verifikuar për shkelje etike është arkivuar pasi pretendimet janë pabazuara
- 2 ankesa të vitit 2014 verifikuar bazuar mbi informacionin periodik ardhur nga kryetari gjykatës në lidhje me vendimet e cenuara i janë regjistruar gjyqtarit për efekt vlerësimi profesional dhe etik
- 1 ankesë e vitit 2014 verifikuar për zvarritje dhe mosrespektim formal ligji është arkivuar pasi pretendimet janë të pabazuara
- 1 ankesë e vitit 2016 është në proces verifikimi për zvarritje gjykim

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin {...} përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore”.

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezultojnë se për gjyqtarin {...}, në periudhën e vlerësimit nuk rezultojnë të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Në relacionet e hartuara nga Inspektorati i KLD rezultojnë se shkak i referimit për t’u mbajtur në konsideratë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit ka qenë cenimi i vendimit nga gjykata

më e lartë për mënyrën e zbatimit të vendimit unifikues nr.4, datë 10.12.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. (materiali nr.1 dhe nr.2), si dhe në vendimin nr.2518/1 Prot., datë 03.06.2021 të ILD, shkak verifikimi është bërë ankesa për zvarritje të gjyqimit (materiali nr.3).

Nuk konstatohet në relacionet e hartuara nga Inspektorati i KLD si dhe në vendimin nr.2581/1 Prot., datë 03.06.2021, të jenë evidentuar elementë që dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërbajtjeje, ndjeshmërie, vëmendjeje apo prania e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të etikës në punë.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së gjyqtarit në treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 35 pikë.

3.B. INTEGRITETI I GJYQTARIT

Lidhur me këtë nënkriter, në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit {...} dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm”.

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtarin {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Rezulton të jenë paraqitur nëntë ankesa, referuar dhe analizuar në treguesin më sipër, të cila janë verifikuar nga Inspektorati i KLD dhe nga ILD. Në materialet për verifikimin e ankesave rezulton se nuk janë konstatuar të dhëna që të dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarit, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Nga vendimin e KPK-së, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI-së dhe hetimit administrativ të kryer nga KPK, konkludohet se *“Si konkluzion, Komisioni vlerëson se në analizë të rasteve të parashikuara nga neni 61 i ligjit nr. 84/2016, të analizuarra më lart, nuk ekziston asnjë prej situatave ligjore që do ta çonte subjektin drejt aplikimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sepse subjekti i rivlerësimit: (i) nuk ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (ii) nuk ka bërë deklaram të rremë; (iii) nuk ka bërë fshehje të pasurisë; (iv) nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit.”*²³

Në të njëjtën kohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 242, datë 28.02.2020, janë shqyrtuar dhe vlerësuar elementë në lidhje me integritetin e gjyqtarit, të cilët pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit figurës, janë gjetur të pabazuara duke konkluduar se: *“Si konkluzion, Komision vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.”*²⁴

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të integritetit, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme, apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e tij.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarit në treguesin *“Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti”* është *“Shumë e lartë”*, duke e pikëzuar me 40 pikë.

²³ Faqe 25 e vendimit të KPK nr. 242, datë 28.02.2020.

²⁴ Faqe 35 e vendimit të KPK nr. 242, datë 28.02.2020.

3.C PAANËSIA E GJYQTARIT

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se *“Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nga nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit {...}. Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Asnjë prej dokumentave ligjorë dhe dosjeve të vëzhguara nuk lidhen me çështje të tjera të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore, të pakicave apo të të miturve. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit”*.

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit, duke përfshirë dhe regjistrimet audio të seancave (*6 dosjet e përzgjedhur me short*).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtari dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të tij. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese nga ana e gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarit në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat statistikore.

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se *“Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve”*

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarit, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore. Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit. Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit (11 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari) nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit. Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, në kushtet kur në rastet e gradimit zbatohen për aq sa është e mundur dispozitat e Ligjit për Statusin, numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është i pakonsiderueshëm.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit. Prandaj, për këtë tregues numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, vlerësohet si i pakonsiderueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” është “I pakonsiderueshëm”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”

| Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE | |
|--|-------|
| Niveli i vlerësimit | Pikët |
| Shkëlqyeshëm | 100 |

4. AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtari {...} ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje profesionale dhe etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Karakteristikë e gjykimeve të tij janë pyetjet drejtuar palëve përgjigjet e të cilave janë vlerësuar edhe në lidhje me çmuarjen e padisë (shih dokumentin 1 dhe dosjen nr.2). Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë. Nga të dhënat e regjistrave të ankesave rezulton se ndaj gjyqtarit {...} është verifikuar 1 ankesë e vitit 2013 për shkelje të etikës gjyqësore e cila më pas është arkivuar pasi pretendimet janë gjetur të pabazuara”.

4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjor të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me shot dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);

- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (kryesisht procesverbaleve të seancave, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore) rezulton se gjyqtari gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i qartë, transparent, i kuptueshëm. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarit për të qartësuar kërkimet e palëve apo për të orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi i tij është i drejtpërdrejtë dhe konkret, në lidhje me çështjen për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë dhe koncize, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “E lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka të dhëna të drejtpërdrejta mbi aftësinë e gjyqtarit {...} për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore. Në këtë aspekt vihet re se nuk ka patur vonesa në arsyetimin e vendimeve gjyqësore, si e dhënë e tërthortë, ndërsa nuk ka patur dështime të seancave për shkak moskryerje njoftimesh në kohë, çfarë tregon produktivitetin e punës së tij në këtë aspekt. Seancat kryesisht kanë dështuar për pamundësi të njoftimit të palëve në adresat e deklaruara nga pala paditëse (shih Aftësitë Organizative”.

4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, shërbejnë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për mungesë të bashkëpunimit me kolegët, për rrjedhojë, prezumohet se ky komunikim është në nivel të lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, prezumohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burim vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është edhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin) dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për rrjedhojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për shkallën e komunikimit me administratën gjyqësore dhe

mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se komunikimi dhe bashkëpunimi me administratën gjyqësore është shumë i lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkalle të ulët të komunikimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për rrjedhojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, prezumohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarit në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARIT PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Për shkak të funksionit që kryen, ai i nënshtrohet detyrimit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ai ka marrë pjesë në 9 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës ku dhe është certifikuar. Këto të dhëna tregojnë se ai ka marrë pjesë në 15 ditë trajnim gjithsej. Lënda e trajnimeve, ku ai ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë. Nga përmbajtja e vërtetimit të Shkollës së Magjistraturës rezulton se gjyqtari {...} ka marrë pjesë si ekspert dhe lehtësues në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në aktivitetet trajnuese me temë “Aspektet procedurale të të drejtës së padisë”, të organizuara përkatësisht në datat 26-27 maj 2014, 28-29 janar 2015 dhe 7 prill 2015”.

4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARIT NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDIET TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, vërtetimit me nr. 999/1 Prot., datë 31.10.2016 të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetëvlerësimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se ai ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e ekspertit, lehtësuesit dhe pjesëmarrësit.

Konkretisht, referuar akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit dhe vërtetimit me nr.999/1 Prot., datë 31.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës, gjyqtari {...} është

angazhuar në aktivitete trajnuese në cilësinë e ekspertit në 1 (një) aktivitet trajnues, gjithsej 2 ditë, në cilësinë e lehtësuesit në 2 (dy) aktivitete trajnuese gjithsej 3 ditë dhe në cilësinë e pjesëmarrësit në 8 (tetë) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 14 ditë trajnimi.

Duke iu referuar nenit 55, pika 9²⁵ të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës, pjesëmarrja në programimin e trajnimit vazhdues në cilësinë e ekspertit ose lehtësuesit ka vlerë edhe për efekt të përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e programit të trajnimit vazhdues, duke u përlllogaritur 1 ditë pjesëmarrje si ekspert e barabartë me 2.5 ditë si pjesëmarrës dhe 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues me 2 ditë si pjesëmarrës. Referuar këtij parashikimi, rezulton se gjyqtari {...}, gjatë periudhës trevjeçare të vlerësimit ka marrë pjesë në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës për 25 ditë në gjithë periudhën e vlerësimit.

Për periudhën e vlerësimit nuk rezulton që gjyqtari të ketë marrë pjesë në aktivitete profesionale jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

²⁵ Në nenin 55, pika 9 të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës parashikohet se :”Për efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në aktivitetet e Formimit Vazhdues, përlllogaritja e ditëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar si ekspertë, lehtësues dhe moderatorë do të bëhet si më poshtë:

- 1 ditë pjesëmarrjeje si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrje në trajnim.

Ky kontribut vlen vetëm për përlllogaritjen e ditëve si pjesëmarrës në Formimin Vazhdues dhe nuk sjell efekte financiare.”.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile, gjithsej 11 aktivitete të zhvilluara për 25 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën trevjeçare.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Shkollën e Magjistraturës dhe trajnime të tjera profesionale, është nga 15-120 ditë, duke e pikëzuar me 20 pikë.

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARIT PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtarit në veprimtari trajnuese.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklaramit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, rezulton se ai është angazhuar në programin e formimit vazhdues së Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e ekspertit në 1 (një) aktivitet trajnues dhe në cilësinë e lehtësuesit në 2 (dy) aktivitete trajnuese brenda Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtarin {...} duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e tij në cilësinë e ekspertit dhe lehtësuesit në disa aktivitete trajnuese në Shkollën e Magjistraturës, ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si ekspert dhe lehtësues.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.

4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARIT NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, formularit të deklaramit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, si dhe akteve të paraqitura nga gjyqtari lidhur me këtë tregues, rezulton që gjyqtari për periudhën e vlerësimit 2013-2016 të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë, siç janë mësimdhënia dhe kontributi për hartimin dhe ndryshimin e legjislacionit.

Konkretisht, gjyqtari ka dhënë mendim në lidhje me projektligjin për ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile të miratuar me ligjin nr. 114/2016, datë 03.11.2016, duke paraqitur si provë komunikimin e postës elektronike të datës 17.10.2016. Po kështu, rezulton se në vitet 2014 dhe 2015 gjyqtari {...} është angazhuar si pedagog i jashtëm në Fakultetin e Drejtësisë të UT, në lëndën “Procedurë civile”, referuar vërtetimit nr. 28 Prot, datë 12.01.2017, të Fakultetit të Drejtësisë.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtarin {...} ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, rezulton angazhim i gjyqtarit, duke e pikëzuar me 5 pikë.

4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se *“Në jetëshkrimin i cili i është bashkëlidhur Formularit, subjekti ka pasqyruar bashkautorësinë e tij në disa botime si dhe autor i disa artikujve në fushën e drejtësisë”*.

Në lidhje me angazhimin e gjyqtarit në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nga aktet e dorëzuara nga gjyqtari nëpërmjet postës elektronike, në datën 11.05.2021, evidentohet se gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtari ka realizuar publikime ligjore akademike me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës si më poshtë:

- “Procedurë Civile, Pjesa e Parë”, vitit 2013, bashkëautor;
- “Procedurë Civile, Pjesa e dytë”, vitit 2014, bashkëautor.

Sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit për gjyqtarin {...} ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari të ketë realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për rrjedhojë, ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Publikime ligjore akademike” rezulton realizimi i publikimeve nga ana e gjyqtarit, duke u pikëzuar me 5 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”

| Niveli i vlerësimit | |
|--|-------|
| KRITERI | |
| AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL | |
| Niveli i vlerësimit | Pikët |

| | |
|--------------|-----|
| Shkëlqyeshëm | 100 |
|--------------|-----|

**NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE
NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT**

| Niveli i vlerësimit për çdo kriter | | |
|--|-------|---------------------|
| Kriteri | Pikët | Niveli i vlerësimit |
| 1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit | 100 | Shkëlqyeshëm |
| 2. Aftësitë organizative të gjyqtarit | 90 | Shkëlqyeshëm |
| 3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale | 100 | Shkëlqyeshëm |
| 4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional | 100 | Shkëlqyeshëm |
| Niveli i përgjithshëm i vlerësimit | | |
| Vlerësimi i përgjithshëm | 390 | Shkëlqyeshëm |

SHTOJCA 1

KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE

NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTARIN {...}

PERIUDHA E VLERËSIMIT 2013-2016

| 1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT | | | |
|--|---|--|---------------|
| Treguesit | Burimet | Shkalla e aftësisë | |
| A. Njohuritë ligjore | a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). | Shumë e lartë |

| | | | |
|---|---|--|--|
| | | | |
| | b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). | Shumë e lartë |
| B. Arsyetimi ligjor | a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). | Shumë e lartë |
| | b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). | Shumë e lartë |
| | c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). | Shumë e lartë |
| 2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT | | | |
| Tregues | | Burimet | Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit |
| A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë | a. Respektimi i afateve ligjore | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e | 21-30 % |

| | | | |
|--|---|--|--|
| | | <i>përzgjedhura me short).</i> | |
| | b. Plotësimi i standardeve minimale kohore | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). | 0-10 % |
| | c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). | Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve |
| | ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. | Mbi 87- 93 % |
| | d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e | Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve |

| | | | |
|---|---|--|--|
| | | <p><i>përzgjedhura me short</i>);</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar. | |
| <p>B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore</p> | <p>a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive</p> | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). | <p>1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë</p> |
| | <p>b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor</p> | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). | <p>Shumë e lartë</p> |
| <p>C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore</p> | <p>a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes</p> | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). | <p>Shumë e lartë</p> |

| | | | |
|--|--|--|---------------|
| | b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). | Shumë e lartë |
|--|--|--|---------------|

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

| Tregues | | Burimi | Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit |
|-----------------------------------|--|--|---------------------------------------|
| A. Etika në punë | a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. | Shumë e lartë |
| B. Integriteti i gjyqtarit | a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. | Shumë e lartë |
| C. Paanësia e gjyqtarit | a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). | Shumë e lartë |

| | | | |
|--|--|-------------------------|---------------------|
| | b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranura të palëve për përjashtimin e gjyqtarit | ▪ Dosja e rivlerësimit. | I pa konsiderueshëm |
|--|--|-------------------------|---------------------|

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

| Tregues | | Burimi | Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit |
|---------------------------------------|--|--|---------------------------------------|
| A. Aftësia e komunikimit | a. Komunikimi i qartë dhe transparent | ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). | Shumë e lartë |
| | b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale | ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). | I lartë |
| B. Aftësia për të bashkëpunuar | a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta | ▪ Dosja e rivlerësimit. | Shumë e lartë |
| | b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore | ▪ Dosja e rivlerësimit. | Shumë e lartë |

| | | | | |
|--|--|-------------------------|-------------|--|
| | | | | |
| C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera | a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale | ▪ Dosja e rivlerësimit. | 15-120 ditë | |
| | b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve | ▪ Dosja e rivlerësimit. | Ka të dhëna | |
| | c. Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata | ▪ Dosja e rivlerësimit. | Ka të dhëna | |
| | ç. Publikimet ligjore akademike | ▪ Dosja e rivlerësimit. | Ka të dhëna | |
| PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT | | 390 | | |
| NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT | | Shkëlqy | | |